

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-192/14

Prishtinë, 27 korrik 2016

Në çështjen juridike të:

P. V.

Pala ankuese

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin (KPA00656) të datës 13 Mars 2014), pas shqyrtimit të mbajtur më 27 Korrik 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM:

1. **Refuzohet si e pabazuar ankesa e P. V., e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 të datës 13 mars 2014.**
2. **Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 i datës 13 mars 2014 për sa i përket kërkesës të regjistruar në KPCC nr. 00656**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. P. V. ka paraqitur një kërkesë si titullar i drejtës pronësore me të cilën ka kërkuar të drejtën pronësore në banesën e tij që gjendet në Prishtinë në rr. “Vojvode Misiqa” nr. 28 me sipërf. prej 57.62 m2. Ai thekson se banesën e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke cekur datën 1.6.1999 si datën e humbjes. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA 00656.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese ka dorëzuar këto dokumente:
 - Vendimin e ndarjes së banesës së kërkuar nr.2471 e datës 25.11.1996 të lëshuar nga Shoqëria aksionare “Kosmet Put”, që referohet banesës që është objekt i kërkesës,
 - Kontratën e shitblerjes të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, Vr.II.nr.26/2000 e datës 26.6.2000;
 - Aneks kontratën Vr.nr.II.26/2000 datë 26.6.2000
3. Dokumentet e mësipërme nuk janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.
4. Banesa është notifikuar më datë 15 janar 2008, 3.1.2008, 9.1.2008 dhe 15.1.2008 por uzurpuesi nuk ishte gjetur në këtë banesë.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj **KPCC/D/R/231/2014 i datës 13.3.2014 ka refuzuar kërkesën** e P. V. si të pabazuar. Me arsyetimin e këtij vendimi në paragrafët 60 , 61 dhe 62 ka konstatuar se paraqitësi i kërkesës ka pretenduar konfirmimin e së drejtës së pronësisë për pronën e kërkuar, por, megjithatë ai nuk ka paraqitur prova juridikisht të vlefshme dhe nuk ka propozuar fakte relevante juridikisht të vlefshme për të vërtetuar të drejtën e tij pronësore për banesën që është objekt i kërkesës. Dokumentet e paraqitura Sekretaria Ekzekutive i AKP-së nuk i janë verifikuar pozitivisht. Matej,

me vendimin ankimor të KPCC-së konstatohet se pavarësisht verifikim negativ të dokumenteve të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës, nuk ka paraqitur kontratën e shfrytëzimit të banesës dhe marrjen në posedim të së njëjtës banesë të parashikuar sipas Ligjit për marrëdhëniet banesore nr. 42/86 dhe Ligjit për banesa nr. 50/92.

6. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 23.5.2014 kurse ka paraqitur ankesë më 12.6.2014.

Pretendimet e palëve

7. Pala ankuese, P. V. pretendon se vendimi ankimor i KPCC-së është marrë me vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Më tej, ai thekson se sipas kontratës së blerjes të banesës Vr.nr.26/2000 e datës 26.6.2000 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë dhe aneks kontratës Vr.nr.2052/07 datë 21.8.2007, ai është pronar ekskluziv i asaj banese ndaj edhe kërkon prej Gjykatës Supreme që ta vërtetojë pronësinë në këtë banesë. Në fund thekson se Komisioni për shqyrtimin e kërkesave pronësore nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për t'i verifikuar këto dokumente të tij dhe se ato janë të vërteta.

Arsyetim ligjor

Pranueshmëria e ankesës

8. Ankesa është e pranueshme, pasi është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç parashikohet në nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

9. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.

10. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të vendimit ankimor, shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të theksuara në ankesë sipas dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

11. Gjykata Supreme vëren se vendimi ankimor i KPCC-së është i drejtë, i plotë, i saktë, i kuptueshëm dhe përfshinë shpjegimin edhe sqarimin e të gjitha fakteve vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm. KPCC me vendimin e tij ka bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike mbi bazën e së cilës drejt ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës pronësore për banesën që është

objekt i kësaj kërkesë. Bashkëngjitur kërkesës , paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur edhe kontratat e theksuara si dhe provat tjera që nuk janë relevante për vendimmarrjen e kësaj çështje juridiko-banesore por edhe ato kontrata sipas Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së nuk janë vërtetuar pozitivisht.

- 12.Me të drejtë KPCC-ja vëren në vendimin ankimor të par. 62 se , pavarësisht verifikimit negativ të kontratave, por ai sipas Ligjit të marrëdhënieve banesore nr. 42/86 dhe Ligjit të banesave 52/92 ka qenë i detyruar që të paraqesë provën që ka lidhë kontratën për shfrytëzimin e asaj banese dhe atë banesë ta ketë pasur në posedim. Pikërisht për këto shkaqe dhe arsye bazuar në dëshmitë e paraqitura nga paraqitësi i kërkesës, i drejtë dhe i ligjshëm është përfundimi i Komisionit se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën banesore për pronën e kërkuar. Prandaj rrjedhimisht kërkesa është refuzuar.
- 13.Objekti i shqyrtimit dhe të vlerësimit të veçantë të gjykatës ishin edhe pretendimet e ankuesit se Komisioni nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të vërtetuar provat e paraqitura por gjeti se ato pretendime janë të pabazuara, të papranueshme , të pasakta dhe rrjedhimisht të kundërligjshme. Kjo pikërisht për arsye se, në vendimin ankimor janë dhënë sqarime të drejta, të plota dhe të qarta e të kuptueshme se Komisioni përkatësisht Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje maksimale për të bërë vërtetësinë, saktësinë dhe autenticitetin e atyre kontratave por megjithatë të njëjtat janë verifikuar negativisht. Gjykata konkludon se sikundër Komisioni por edhe Gjykata Supreme nuk mund t'i mbështet vendimin e saj për të pranuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës mbi bazën e dokumenteve të cilat janë verifikuar negativisht.
- 14.Objekti i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin edhe disa dokumente tjera të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës-ankesës, por të njëjtat nuk ishin me ndikim relevant në marrjen e një vendimi tjetër lidhur me këtë çështje banesore.
15. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja e ka bazuar vendimin në përcaktimin korrekt dhe të plote të gjendjes faktike dhe në aplikimin e duhur të ligjit material. Prandaj, Gjykata Supreme arrin në përfundimin se ankesa është e pabazuar.
- 16.Në bazë të arsyeve të lartpërmendura në pajtim me nenin 13.3.c të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 200 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vërtetohet vendimi i KKPK-së dhe refuzohet ankesa si e pabazuar.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it